

## **Statuti**

I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

**AMAR Pharma SHPK.**

### **NENI I**

#### **EMËRTIMI**

Emri i shoqërisë më përgjegjësi të kufizuar është "**AMAR Pharma Shpk.**", që më poshtë do të quhet "Shoqëria".

### **NENI II**

#### **PERSONALITETI JURIDIK**

Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

### **NENI III**

#### **SELIA**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Rr. Sulejman Pitarka; Ndërtesa 11; H.11, A1; Tirane. Shoqëria mund të hapë edhe zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale dhe/ose të realizojë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera, siç parashikohet nga ligji, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

### **NENI IV**

#### **KAPITALI**

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) i përberë nga 1 kuote e zotëruar nga ortaku:



Znj. Megi Hoxha; shtetase shqiptare, banuese në Tirane në adresë Rr. Sulejman Pitarka;  
Ndërtesa 11; H.11, A1; Tiranë, mbajtëse e Letërnjoftimit nr. 039134176,

Kuota e kapitalit është e transferueshme dhe e pjesëtueshme sipas kushteve të parashikuara në këtë statut dhe në ligjin shqiptar për shoqëritë tregtare.

Ortaket do të kenë përparësi në blerjen e kuotave ndaj palëve të treta në përpjesëtim të drejtë me pjesën e tyre në kapital.

Nëse asnjë prej ortakeve nuk është dakord për blerjen e kuotave të ortakut që i shet ato, ky i fundit është i lire ti shesë ato në treg të lire.

Përgjegjësia e ortakut për humbjet e Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin e Shoqërisë.

## **NENI V**

### **OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrjen në çdo veprim apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryeje një shoqëri më përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në baze të legjislacionit shqiptar.

Më konkretisht por pa u kufizuar në to Shoqëria ka për objekt:

- i.** aktivitetin e transportit të udhëtareve si brenda dhe jashtë vendit;
- ii.** aktivitetin e ndërtimit, drejtimit dhe dhënien e marrjen më qira të strukturave pritëse hoteliere (hotele, pensione, fshatra turistike, etj), dhe ekstra hoteliere, etj.;
- iii.** aktivitetin e ndërtimit dhe atë që ka lidhje më pasuritë e paluajtshme, si për llogari të vet ashtu edhe për llogari të enteve publike dhe private, si edhe ndërtimin, restaurimin, riparimin, shkëmbimin, blerjen, shitjen, dhënien më qira, menaxhimin, administrimin e pasurive të paluajtshme të veta ose të të tretëve, tregtare ashtu edhe industriale, edhe të mobiluara, lidhja e kontratave të sipërmarrjes si dhe zhvillimi i të gjitha aktiviteteve të lidhura direkt ose indirekt më aktivitetin e ndërtimit dhe atë

- që ka lidhje më pasuritë e paluajtshme në përgjithësi përfshirë aktivitetin e ndërmjetësimit në lidhje më pasuritë e paluajtshme;
- iv.** realizimin dhe aktivitetin e drejtimit të impianteve, aparaturave dhe teknologjive të ndryshme në fushën e industrisë.
- v.** përfaqësimin direkt, si agjent ose mbi baza porosie, të shoqërive që veprojnë në sektorin e pasurive të paluajtshme;
- vi.** Blerje-shitje, më shumice dhe pakice; import-eksport; riparim, mbajtje ruajtje, shpërndarje, prodhim e paketim:
- të instrumenteve dhe pajisjeve, përfshirë instrumente dhe pajisje që shërbejnë për diagnostikim apo kurim apo pajisjeve mjekësore të çdo lloji;
  - të produkteve farmaceutike dhe të lëndëve kontraste për njerëz apo kafshë;
  - të materialeve mjekësore;
  - të produkteve stomatologjike dhe produkteve të higjienës orale në tërësi;
  - të produkteve të higjienës personale,
  - të ushqimeve, shtesave ushqimore dhe të vitaminave;
  - të produkteve dermokozmetike dhe kozmetike;
  - të produkteve pastruese dhe dezinfektuese; etj.
- vii.** Krijimin e qendrave këshilluese, diagnostikuese e kuruese apo të qendrave të mirëqenies trupore (masazhe, SPA, trajtime kozmetike etj.

Shoqëria gjithashtu mund të ushtroje çdo aktivitet tregtar që lejohet nga ligji dhe që nuk pengon apo ndalon zhvillimin e ndonjë prej aktiviteteve të përshkruara më sipër.

## **NENI VI**

### **KOHEZGJATJA**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin që ka për objekt për një periudhë kohore pa afat.

## **NENI VII**

### **ASAMBLEJA E ORTAKEVE**



## 1. Funksionimi dhe Kompetencat .

Asambleja e Ortakëve të shoqërisë në përputhje më legjislacionin shqiptar, merr vendime më shumice të cilësuar dhe vendime më shumice të zakonshme. Për marrjen e vendimeve më shumice të cilësuar

Ortakët e Shoqërisë bien dakord që kuorumi i mbledhjeve të vlefshme është më ortake që përfaqësojnë të paktën 67% të kapitalit të Shoqërisë dhe vendimet merren kur për to votojnë ortaket që përfaqësojnë se paku 67% të kuotave të kapitalit.

Vendimet që kërkojnë shumice të cilësuar do të jenë:

- Transferimi i kuotës gjate 5 viteve të para që nga momenti i themelimit të Shoqërisë (shitblerje, dhurim etj.). Këtu përjashtohen rastet kur transferimi behet tek anëtarët e familjes së ortakut me trashëgim ligjor apo testamentar.
- Marrja e kredive që tejkalojnë 50% të xhiros se vitit financiar paraardhës. Për vitin e pare financiar kjo shume është 150.000 euro;
- Shpërndarja e disidentit;
- Ndryshimi i statutit të Shoqërisë;

Vendimet e tjera miratohen më shumice të thjeshte ndërkohë që kuorumi i pjesëmarrjes për të marre vendime të vlefshme duhet të jete jo më pak se 50%.

## 2. Vendi i mbledhjes se Asamblesë

Mbledhjet e asamblesë e ortakeve do të bëhen në një vend brenda ose jashtë Republikës se Shqipërisë, siç mund të përcaktohet në çdo kohe nga ortaket. Në qofte se një vend i tille nuk është caktuar, mbledhjet do të bëhen në selinë e Shoqërisë.



## NENI VIII

### ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

#### 1. Kompetencat.

Pasuria, aktiviteti dhe biznesi i Shoqërisë do të drejtohet dhe administrohet nga të paktën 1 administrator, i cili mund të ushtroje çdo kompetence e mund të kryejnë çdo veprim të ligjshëm në emër të Shoqërisë më përjashtim të atyre që ligji apo ky Statut ia rezervon Asamblesë së Ortakeve.

Çdo transaksion në emër të Shoqërisë do të lidhet me nënshkrimin e Administratorit.

Administratori ka të drejte t'u delegoje me prokure një pjese apo të gjitha kompetencat e tij personave të trete të caktuar prej tij.

Asambleja mund të vendose dhe kompetenca të veçanta për secilin prej administratoreve.

#### 2. Emërimi dhe Kohëzgjatja e Mandatit.

Administratori do të emërohet më vendim të marre më shumice të thjeshte votash nga Asambleja e Ortakeve. Mandati i Administratorit është 5 vjet i rinovueshem.

Administratori i pare i kësaj shoqërie do të jetë Znj. Megi Hoxha; shtetase shqiptare, banuese në Tirane në adrese Rr. Sulejman Pitarka; Ndërtesa 11; H.11, A1; Tiranë, mbajtëse e Letërnjoftimit nr. 039134176,

#### 3. Shkarkimi.

Administratori mund të shkarkohet në çdo moment më ose pa shkak, më vendim të marre nga ortaket që perfaqesojne 50%+1 të kuotes ae Shoqërisë.



#### 4. Përgjegjësitë.

Administratori është individualisht përgjegjës ndaj Shoqërisë ose të tremeve për dëme si rrjedhojë e shkeljes së klauzolave të këtij Statuti apo të ligjit nga ana e tyre.

### **NENI IX**

#### **EKSPERTI KONTABËL I AUTORIZUAR**

Eksperti(et) kontabël i(të) autorizuar do të emërohet(n) me vendim të Asamblesë së Ortakeve në çdo rast kur një gjë e tillë kërkohet nga ligji shqiptar.

### **NENI X**

#### **VITI FINANCIAR**

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

Përbashimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar dhe mbaron më 31 dhjetor 2024.

### **NENI XI**

#### **SHPËRNDARJA**

Në çdo moment e për çdo arsye që arrihet në shpërndarjen e Shoqërisë, normat për kryerjen e likuidimit dhe emërimin e likuidatorit janë ato që parashikohen nga ligji shqiptar në fuqi.

### **NENI XII**

#### **BAZA LIGJORE**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë Statut dhe me ligjin shqiptar.




Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, do të aplikohen normat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

### **NENI XIII**

### **NDRYSHIMET**

Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet, shfuqizohet i teri e të zevendesohet më një statut të ri me vendim Asamblesë se Ortakeve të Shoqërisë sipas parashikimeve të nenit VII/1 më lart.

Nënshkruhet sot më date 28/062024.



**Znj. Meg Hoxha**

Ortak i Vetëm

Administrator